



SPECIALIST PROSECUTOR'S OFFICE
ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR
SPECIJALIZOVANO TUŽILAŠTVO

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-07
Prokurori i Specializuar k. Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Pjesëmarrësi parashtrues: Prokurori i Specializuar

Data: 4 tetor 2021

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Aktakuzë me më pak redaktime

Zyra e Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të Hysni Gucatit

Xhonatan Elistan Ris

Mbrojtësit të Nasim Haradinajt

Tobi Kadman

Prokurori i Specializuar, në përputhje me kompetencën e tij në bazë të neneve 35(2)(i) dhe 38 të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") akuzon:

HYSNI GUCATIN

NASIM HARADINAJN

për **vepra penale kundër administrimit të drejtësisë dhe administratës publike dhe vepra penale kundër rendit publik**, të ndëshkueshme në bazë të Kapitujve II, XXXI, dhe XXXII të Kodit Penal të Republikës së Kosovës nr.06/L-074 (2019) ("KPK") dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit, sikurse shtjellohet në vijim.

TË AKUZUARIT

1. **Hysni GUCATI**, emri i [REDAKTUAR], u lind më 30 mars 1967 në Morinë, komuna e Skënderajt, Kosovë. Adresa e fundit e njohur e tij është [REDAKTUAR], Kosovë. Ai ka shtetësinë kosovare (numri personal [REDAKTUAR]).
2. **Nasim HARADINAJ**, emri i [REDAKTUAR], u lind më 21 maj 1963 në Gllogjan, komuna e Deçanit, Kosovë. Adresa e fundit e njohur e tij është [REDAKTUAR], Kosovë. Ai ka shtetësinë kosovare (numri personal [REDAKTUAR]).
3. Në të gjitha periudhat që lidhen me këtë Aktakuzë, **Hysni GUCATI** ishte kryetar, kurse **Nasim HARADINAJ** nënkryetar i Organizatës së Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ("OVL-UÇK").

PARAQITJE E FAKTEVE

4. Të gjitha veprat penale të paraqitura në këtë Aktakuzë kanë lidhje me procedurat zyrtare të Dhomave të Specializuara ("DHS") dhe hetimet e Zyrës së Prokurorit të Specializuar ("ZPS") (bashkërisht "procedurat e DHS-së"). Të gjitha referencat për dëshmitar ose dëshmitarë në këtë aktakuzë duhet të kuptohen se

përfshijnë të gjithë personat që me gjasë kanë informacion për vepra penale, kryes apo rrethana të rëndësishme në lidhje me procedurat e DHS-së.

5. Midis më së paku prillit dhe shtatorit 2020, **Hysni GUCATI** dhe **Nasim HARADINAJ** bënë deklaratë akuzuese për dëshmitarë që bashkëpunojnë me ZPS-në dhe për persona të tjerë, duke i quajtur ata, ndër të tjera, gënjeshtarë, bashkëpunëtorë dhe tradhtarë. Kjo sjellje tregon qartë synimin dhe motivin e tyre për të dëmtuar dhe penguar procedurat e DHS-së.

6. Sikurse shtjellohet më poshtë, midis më së paku 7 dhe 25 shtatorit 2020, **Hysni GUCATI**, **Nasim HARADINAJ**, Faton KLINAKU (sekretar i OVL-UÇK-së), Tomë GASHI (avokat i OVL-UÇK-së) dhe anëtarë e përfaqësues të tjerë të OVL-UÇK-së (bashkërisht me Faton KLINAKUN dhe Tomë GASHIN, “ndihmësit”), shpërndanë pa autorizim informacion konfidencial dhe jopublik në lidhje me hetimet konfidenciale të Task Forcës Hetimore Speciale (“TFHS”) dhe ZPS-së, inkurajuan të tjerë të shpërndanin më tej informacion konfidencial dhe jopublik, dhe ndërmorën veprime të tjera për qëllimin e deklaruar të pengimit të punës së DHS-së/ZPS-së. Ky informacion konfidencial dhe jopublik përfshinte dokumente të shënuara si “konfidenciale”, dhe emra, të dhëna personale dhe dëshmi të qindra dëshmitarëve të mbrojtur në kontekstin e procedurave të DHS-së dhe procedimeve penale të mëparshme në Kosovë, ose në lidhje me Kosovën.

7. **Hysni GUCATI** dhe **Nasim HARADINAJ** organizuan dhe bashkërenduan së bashku me ndihmësit shpërndarjen e paautorizuar të informacionit konfidencial dhe jopublik dhe veprime të tjera në lidhje me të, ndër të tjera përmes këqyrjes së informacionit konfidencial dhe jopublik, pjesëmarrjes në vendime nëse dhe si të shpërndahej ai informacion, dhe organizimit e pjesëmarrjes në ngjarje në lidhje me të, duke përfshirë konferenca për shtyp dhe paraqitje publike në të cilat u shpërnda dhe diskutua publikisht informacion konfidencial dhe jopublik.

Dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë

8. Më 7 shtator 2020, **Hysni GUCATI** dhe **Nasim HARADINAJ**, përkatësisht në cilësinë e kryetarit dhe nënkryetarit të OVL-UÇK-së, mbajtën një konferencë për shtyp në të cilën **Hysni GUCATI** njoftoi se OVL-UÇK-ja kishte marrë dosje dokumentesh në lidhje me DHS-në/ZPS-në ("konferenca e parë për shtyp"). Gjatë konferencës për shtyp, këto dosje ("dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë") ishin ekspozuar mbi një tavolinë.

9. **Nasim HARADINAJ** deklaroi se gjatë konferencës së parë për shtyp do të viheshin në dispozicion katër kopje të dokumenteve. Ai përmendi emrat, vendin e banimit, vendin e punës, ose të dhëna të tjera personale të katër dëshmitarëve. **Nasim HARADINAJ** shpjegoi gjithashtu se dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë përfshinin emra, adresa, numra telefoni, të dhëna personale të tjera, deklarata dhe informacion në lidhje me dëshmitarë të tjerë të intervistuar, ndër të cilët shqiptarë, romë dhe serbë. **Nasim HARADINAJ** pranoi se dokumentet ishin konfidenciale. Ai deklaroi se OVL-UÇK-ja do t'u dërgonte deputetëve të Kuvendit të Kosovës kopje të dokumenteve dhe se të pranishmëve në konferencën e parë për shtyp do t'u jepte sa kopje të dëshironin. **Nasim HARADINAJ** u bëri thirrje të pranishmëve që të merrnin kopje të dokumenteve dhe t'i shihnin emrat dhe deklaratat e dëshmitarëve.

10. Më 7 shtator 2020, Gjykatësi i Vetëm i DHS-së autorizoi sekuestrimin e dokumenteve që ishin pjesë e dokumenteve të nxjerra gjatë herës së parë, konfirmoi natyrën konfidenciale dhe jopublike të hetimeve të TFHS-së dhe ZPS-së dhe urdhëroi që personat të cilët posedonin dokumentet ose përmbajtjen e tyre, të mos i kopjonin, incizonin ose shpërndanin ato ("Urdhri i Parë"). Më 8 shtator 2020, ZPS-ja dorëzoi Urdhrin e Parë dhe sekuestroi dokumentet në ambientet e OVL-UÇK-së. Materialet e sekuestruara përfshinin informacion konfidencial dhe jopublik në lidhje me hetimet konfidenciale, ndër të tjera identitetin, të dhënat personale dhe dëshmitë e dëshmitarëve.

11. Pas konferencës së parë për shtyp, midis 7 dhe 15 shtatorit 2020, **Hysni GUCATI** dhe **Nasim HARADINAJ** bënë deklaratatë të shumta publike lidhur me dokumentet e nxjerra gjatë herës të parë. Në kuadër të atyre deklaratave, **Hysni GUCATI** dhe/ose **Nasim HARADINAJ** publikisht:

- i. konfirmuan se përfaqësuesve të shtypit u ishin dhënë kopje të dokumenteve të nxjerra gjatë herës së parë;
- ii. zbuluan më shumë nga përmbajtja e dokumenteve të nxjerra gjatë herës së parë, duke përfshirë hollësi të hetimeve konfidenciale;
- iii. deklaruan se në dokumentet përmendeshin me emër dëshmitarë, si dhe përmendën datat dhe vendet e kryerjes së disa intervistave;
- iv. akuzuan dëshmitarët e përmendur me emër në dokumente se ishin, ndër të tjera, gënjeshtarë, tradhtarë dhe spiunë;
- v. inkurajuan përfaqësues të shtypit që të publikonin dokumentet e përfshira në dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë;
- vi. deklaruan se nëse do të merrnin informacion konfidencial dhe publik të mëtejshëm, do ta shpërndanin publikisht; dhe
- vii. deklaruan se nuk e njihnin DHS-në/ZPS-në dhe se veprimet e tyre kishin për qëllim pengimin e DHS-së/ZPS-së.

12. Pas konferencës së parë për shtyp dhe gjatë ditëve që vijuan, disa përfaqësues të shtypit dhe të publikut shpërndanë më tej në shtyp dhe në Internet informata me emra dhe të dhëna personale dëshmitarësh që përfshiheshin në dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë.

Dokumentet e nxjerra gjatë herës së dytë

13. Më 16 shtator 2020, **Hysni GUCATI** dhe **Nasim HARADINAJ**, përkatësisht në cilësinë e kryetarit dhe nënkryetarit të OVL-UÇK-së, mbajtën konferencë për shtyp ("konferenca e dytë për shtyp") në të cilën **Hysni GUCATI** deklaroi se OVL-UÇK-ja kishte marrë një paketë tjetër dokumentesh. Ai u tha të pranishmëve se mund t'i merrnin dokumentet ("dokumentet e nxjerra gjatë herës së dytë"). Ndërsa po tregonte

njërën nga dokumentet, **Hysni GUCATI** përmendi me emër dy persona që kishin bashkëpunuar me TFHS-në.

14. **Nasim HARADINAJ** përsëriti emrin e një personi që tashmë ishte përmendur nga **Hysni GUCATI**, përmendi me emër një person tjetër që kishte bashkëpunuar me TFHS-në, dhe zbuloi informacion konfidencial dhe jopublik të mëtejshëm në lidhje me hetimet konfidenciale. **Nasim HARADINAJ** u tha të pranishmëve në konferencën e dytë për shtyp se dokumentet ishin në dispozicion për të gjithë dhe u tha të pranishmëve që t'i merrnin ato.

15. Më 17 shtator 2020, Gjykatësi i Vetëm i DHS-së autorizoi sekuestrimin e dokumenteve që ishin pjesë e dokumenteve të nxjerra gjatë herës së dytë, konfirmoi natyrën konfidenciale dhe jopublike të informacionit nga hetimet e TFHS-së dhe ZPS-së dhe urdhëroi që personat të cilët posedonin dokumentet ose përmbajtjen e tyre të mos i kopjonin, incizonin ose shpërndanin ato ("Urdhri i Dytë"). Më vonë atë ditë, ZPS-ja dorëzoi Urdhrin e Dytë dhe sekuestroi dokumentet në ambientet e OVL-UÇK-së. Materiali i sekuestruar përfshinte (i) dokumente në lidhje me procedime penale të mëparshme në Kosovë dhe në Tribunalin Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë; dhe (ii) dokumente në lidhje me hetime konfidenciale, të cilat kishin qenë gjithashtu pjesë e dokumenteve të nxjerra gjatë herës së parë dhe përfshinin identitetin ose të dhënat personale të më së paku tre dëshmitarëve.

16. Pas konferencës së dytë për shtyp, midis 17 dhe 21 shtatorit 2020, **Hysni GUCATI**, **Nasim HARADINAJ** dhe Tomë GASHI bënë deklaratatë të shumta publike në lidhje me dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë dhe gjatë herës së dytë. Në kuadër të atyre deklaratave, **Hysni GUCATI** dhe/ose **Nasim HARADINAJ** publikisht:

- i. pranuan se dokumentet e nxjerra gjatë herës së parë dhe gjatë herës së dytë kishin përmbajtje të ndjeshme, konfidenciale dhe jopublike;
- ii. pranuan se me ligj nuk duhet të publikohen identiteti dhe të dhënat personale të dëshmitarëve;

- iii. pretenduan se dokumentet e sekuestruara nga ZPS-ja ishin vetëm një pjesë e dokumenteve të shpërndara gjatë dhe pas konferencës së dytë për shtyp, pasi që përfaqësues të shtypit dhe të tjerë tashmë kishin marrë pjesën tjetër të tyre;
- iv. konfirmuan se urdhrat e DHS-së ndalonin shpërndarjen e mëtejshme të përmbajtjes së dokumenteve të nxjerra gjatë herës së parë dhe gjatë herës së dytë;
- v. konfirmuan se dokumentet e nxjerra gjatë herës së dytë u ishin vënë në dispozicion përfaqësuesve të shtypit dhe ishin marrë prej tyre;
- vi. zbuluan më shumë nga përmbajtja e dokumenteve të nxjerra gjatë herës së parë dhe gjatë herës së dytë, duke përfshirë hollësi të hetimeve konfidenciale;
- vii. konfirmuan se dokumentet e shpërndara përmbanin identitetin dhe të dhëna personale të dëshmitarëve;
- viii. akuzuan dëshmitarët e përmendur në informacionin konfidencial se ishin, ndër të tjera, gënjeshtarë, spiunë dhe tradhtarë;
- ix. falënderuan dhe lavdëruan personat që i kishin dhënë OVL-UÇK-së dokumentet e nxjerra gjatë herës së dytë;
- x. premtuan se do të publikonin çfarëdo informacioni konfidencial dhe jopublik të mëtejshëm që do t'i jepej OVL-UÇK-së në lidhje me DHS-në/ZPS-në;
- xi. sfiduan përfaqësuesit e shtypit që nuk kishin publikuar informacionin konfidencial dhe jopublik;
- xii. u thanë përfaqësuesve të shtypit që të publikonin informacionin konfidencial dhe jopublik; dhe
- xiii. deklaruan se nuk e njihnin DHS-në/ZPS-në dhe se veprimet e tyre kishin për qëllim pengimin e DHS-së/ZPS-së.

Dokumentet e nxjerra gjatë herës së tretë

17. Më 22 shtator 2020, **Hysni GUCATI** dhe **Nasim HARADINAJ**, përkatësisht në cilësinë e kryetarit dhe nënkryetarit të OVL-UÇK-së, mbajtën konferencë për shtyp ("konferenca e tretë për shtyp") në të cilën **Hysni GUCATI** deklaroi se OVL-UÇK-ja kishte marrë dokumente që besohet se kishin rrjedhur nga DHS-ja/ZPS-ja ("dokumentet e nxjerra gjatë herës së tretë"). **Hysni GUCATI** tregoi njërin prej dokumenteve dhe ftoi të pranishmit që të afroreshin për të parë dokumentin.

18. **Nasim HARADINAJ** deklaroi se dokumentet kishin stemën e ZPS-së dhe se, me sa kuptonte ai, ishin në lidhje me një projektatakuzë. Duke iu referuar përmbajtjes së dokumenteve, ai përmendi me emër pesë persona të akuzuar të mundshëm, [REDAKTUAR], dhe identifikoi persona dhe vendndodhje të tjera të përmendura në dokument. **Nasim HARADINAJ** ftoi të pranishmit që të shihnin, incizonin dhe publikonin përmbajtjen e dokumenteve. Ai gjithashtu deklaroi se OVL-UÇK-ja do të merrte dhe shpërndante informacion të mëtejshëm konfidencial dhe jopublik në lidhje me DHS-në/ZPS-në.

19. Më 22 shtator 2020, ZPS-ja nxori një urdhër për dorëzimin e dokumenteve që ishin pjesë e dokumenteve të nxjerra gjatë herës së tretë, dhe që personat që posedonin këto dokumente apo përmbajtjen e tyre, të mos i kopjonin, incizonin ose shpërndanin ato ("Urdhri i Tretë"). Në të njëjtën ditë, ZPS-ja dorëzoi Urdhrin e Tretë dhe sekuestroi dokumentet në ambientet e OVL-UÇK-së. Materialet e sekuestruara përfshinin informacion konfidencial dhe jopublik në lidhje me hetimet konfidenciale, duke përfshirë identitetin, të dhëna personale dhe dëshmi të dëshmitarëve.

20. Pas konferencës së tretë për shtyp, midis 22 dhe 25 shtatorit 2020, **Hysni GUCATI** dhe **Nasim HARADINAJ** bënë deklaratatë të shumta publike në lidhje me dokumentet e nxjerra gjatë herës së tretë. Në kuadër të atyre deklaratave, **Hysni GUCATI** dhe/ose **Nasim HARADINAJ** publikisht:

- i. konfirmuan që dokumentet e nxjerra gjatë herës së tretë, iu shpërndanë shtypit;

- ii. [REDAKTUAR];
- iii. inkurajuan personat që posedonin informacion konfidencial dhe jopublik në lidhje me DHS-së/ZPS-në, që të vazhdonin t'i jepnin informacion të tillë OVL-UÇK-së;
- iv. premtuan se do të publikonin çfarëdo informacioni konfidencial dhe jopublik të mëtejme qo do t'i jepej OVL-UÇK-së në lidhje me DHS-në/ZPS-së; dhe
- v. deklaruan se nuk e njihnin DHS-në/ZPS-në dhe se veprimet e tyre kishin për qëllim pengimin e DHS-së/ZPS-së.

21. Pas konferencës së tretë për shtyp dhe gjatë ditëve që vijuan, disa përfaqësues të shtypit dhe të publikut shpërndanë më tej në shtyp dhe në Internet informata me emra dhe të dhëna personale dëshmitarësh që përfshiheshin në dokumentet e nxjerra gjatë herës së tretë.

22. Si pasojë e dokumenteve të nxjerra gjatë herës së parë, të dytë dhe të tretë, si dhe e ngjarjeve në lidhje me to të përshkruara më lart, u frikësuan dëshmitarë dhe/ose anëtarë të familjeve të tyre dhe u vunë në rrezik siguria, privatësia, reputacioni dhe jetesa e tyre. Për më tepër, ZPS-ja u detyrua të merrte masa për të trajtuar pasojat reale dhe të mundshme ndër të tjera për dëshmitarët dhe procedurat e DHS-së.

23. Dokumentet konfidenciale dhe jopublike që u shpërndanë gjatë herës së parë, të dytë dhe të tretë, në vazhdim do të quhen "informacion konfidencial".

Veprat penale

24. Në bazë të fakteve të paraqitura në paragrafët 4-22, **Hysni GUCATI** dhe **Nasim HARADINAJ** mbajnë përgjegjësi penale individuale për çdonjërën nga veprat penale të renditura më poshtë. Sikurse përshkruhet në paragrafët 45-46, ata kishin dijeninë dhe synimin e nevojshëm për çdonjërën nga veprat penale.

Pengimi i personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare

25. Midis më së paku 7 dhe 25 shtatorit 2020, **Hysni GUCATI, Nasim HARADINAJ**, dhe ndihmësit, me anë të kërcënimit të rëndë dhe/ose duke vepruar bashkërisht, penguan ose tentuan të pengonin procedurat e DHS-së. **Hysni GUCATI** dhe **Nasim HARADINAJ** organizuan dhe bashkërenduan grupin që kreu veprime të tilla.

26. Në veçanti, sikurse përshkruhet në paragrafët 6-9, 11-14, 16-18, dhe 20-21, në më shumë raste midis më së paku 7 dhe 25 shtatorit 2020, **Hysni GUCATI, Nasim HARADINAJ**, dhe ndihmësit (i) shpërndanë informacionin konfidencial; (ii) akuzuan dëshmitarët e përmendur në informacionin konfidencial se ishin, ndër të tjera, gënjeshtarë, spiunë dhe tradhtarë; dhe (iii) deklaruan se me shpërndarjen e informacionit konfidencial dhe veprimet e tjera në lidhje me të, ata kishin për qëllim pengimin e procedurave të DHS-së. **Hysni GUCATI** dhe **Nasim HARADINAJ** gjithashtu inkurajuan, udhëzuan dhe këshilluan publikisht:

- i. disa përfaqësues të publikut që posedonin ose kishin qasje në informacion konfidencial në lidhje me procedurat e DHS-së, që të vazhdonin t'i jepnin informacion të tillë OVL-UÇK-së; dhe
- ii. disa përfaqësues të shtypit dhe publikut që të merrnin ose incizonin dhe shpërndanin e publikonin më tej informacionin konfidencial.

27. Më së paku pas nxjerrjes së parë dhe nxjerrjes së tretë të dokumenteve, një pjesë e informacionit konfidencial u shpërnda më tej në shtyp dhe në Internet, sikurse përshkruhet në paragrafët 12 dhe 21.

28. Së fundi, sikurse përshkruhet në paragrafin 22, veprimet e **Hysni GUCATIT, Nasim HARADINAJT**, dhe të ndihmësve penguan ose tentuan të pengonin procedurat e DHS-së: (i) frikësuan dëshmitarë; (ii) rrezikuan aftësinë e ZPS-së për hetimin dhe ndjekjen penale të efektshme të krimeve, përfshirë nëpërmjet marrjes dhe sigurimit të provave të rëndësishme; dhe (iii) ZPS-ja përqendroi kapacitetet dhe kohën

e vet në trajtimin e pasojave reale dhe të mundshme ndër të tjera për dëshmitarët dhe procedurat e DHS-së.

Frikësimi gjatë procedurës penale

29. Midis më së paku 7 dhe 25 shtatorit 2020, **Hysni GUCATI, Nasim HARADINAJ** dhe ndihmësit përdorën kërcënime të rënda për të nxitur ose për të tentuar të nxisin dëshmitarët që të mos japin deklaratë, apo të japin deklaratë të rreme, ose ndryshe të mos i japin informacion të vërtetë ZPS-së dhe DHS-së.

30. Në veçanti, sikurse përshkruhet në paragrafët 6-9, 11-14, 16-18, dhe 20-21, në një numër rastesh, **Hysni GUCATI, Nasim HARADINAJ**, dhe ndihmësit:

- i. u shpërndanë përfaqësuesve të shtypit dhe publikut emra, të dhëna personale dhe dëshmi të qindra dëshmitarëve;
- ii. pranuan që informacioni konfidencial përfshinte emrat dhe të dhënat e dëshmitarëve të mbrojtur;
- iii. gjatë paraqitjeve publike zbuluan identitetin e dëshmitarëve, vendin e banimit, dhe të dhëna personale dhe hollësi të tjera në lidhje me ta, duke përfshirë datat dhe vendet ku ishin intervistuar;
- iv. i akuzuan dëshmitarët e identifikuar në informacionin konfidencial se ishin, ndër të tjera, gënjeshtarë, spiunë dhe tradhtarë;
- v. inkurajuan, udhëzuan dhe këshilluan disa përfaqësues të publikut që posedonin informacion konfidencial në lidhje me procedurat e DHS-së, ose kishin qasje në informacion të tillë, që të vazhdonin t'i jepnin informacion të tillë OVL-UÇK-së;
- vi. inkurajuan, udhëzuan dhe këshilluan disa përfaqësues të shtypit dhe publikut që të merrnin ose incizonin dhe më pas shpërndanin dhe publikonin më tej, informacionin konfidencial;
- vii. deklaruan dhe me veprimet e tyre demonstuan indiferencën e tyre për sigurinë e dëshmitarëve të identifikuar në informacionin konfidencial; dhe

viii. deklaruan se qëllimi i tyre i shpërndarjes së informacionit konfidencial dhe i veprimeve në lidhje me të, ishte pengimi i procedurave të DHS-së.

Hakmarrja

31. Midis më së paku 7 dhe 25 shtatorit 2020, **Hysni GUCATI, Nasim HARADINAJ** dhe ndihmësit ndërmorën ose tentuan të ndërmerrnin veprime të dëmshme kundër dëshmitarëve me synimin e hakmarrjes për dhënien ZPS-së të informacionit të besueshëm në lidhje me kryerjen ose kryerjen e mundshme të veprave penale.

32. Në veçanti, veprimet dhe mosveprimet e përshkruara në paragrafin 30 më lart shkelën të drejtat themelore të dëshmitarëve të garantuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe në Konventën Evropiane për Të Drejtat e Njeriut. U frikësuan dëshmitarë dhe/ose anëtarë të familjeve të tyre dhe u vunë në rrezik siguria, privatësia, reputacioni dhe jetesë e tyre.

Shkelja e fshehtësisë së procedurës

33. Sikurse përshkruhet në paragrafët 6-9, 11-14, 16-18, dhe 20-21, midis më së paku 7 dhe 25 shtatorit 2020, **Hysni GUCATI, Nasim HARADINAJ** dhe ndihmësit zbuluan informacion konfidencial pa autorizim. Ata gjithashtu inkurajuan, udhëzuan dhe këshilluan: (i) disa përfaqësues të publikut që posedonin ose kishin qasje në informacion konfidencial në lidhje me procedurat e DHS-së, që të vazhdonin t'i jepnin informacion të tillë OVL-UÇK-së; dhe (ii) disa përfaqësues të shtypit dhe publikut që të merrnin ose incizonin dhe të shpërndanin e publikonin më tej informacionin konfidencial. Informacioni konfidencial nuk duhej të zbulohet në bazë të Ligjit dhe/ose ishte i klasifikuar nga autoritetet kompetente, ndër të tjera nga DHS-ja, TFHS-ja/ZPS-ja, dhe organizatat dhe shtetet bashkëpunuese në bazë të një marrëveshjeje me TFHS-në/ZPS-në. Informacioni ishte i klasifikuar në përputhje me nenet 4(2), 23, 35(2)(d)-(f), 39, 54(8), 61(3)-(4) dhe 62 të Ligjit.

34. Gjithashtu, sikurse përshkruhet në paragrafët 6-9, 11-14, 16-18, dhe 20-21, midis më së paku 7 dhe 25 shtatorit 2020, **Hysni GUCATI, Nasim HARADINAJ** dhe

ndihmësit zbuluan ose tentuan të zbulonin pa autorizim identitetin dhe të dhënat personale të dëshmitarëve të mbrojtur në kontekstin e procedurave të DHS-së dhe procedimeve të tjera penale të mëparshme në Kosovë. Ata gjithashtu inkurajuan, udhëzuan dhe këshilluan përfaqësues të shtypit dhe publikut që të zbulonin pa autorizim informacion të tillë. **Hysni GUCATI, Nasim HARADINAJ** dhe ndihmësit deklaruan publikisht se informacioni konfidencial përfshinte identitetin, të dhëna personale dhe dëshmi të dëshmitarëve, dhe ishte në lidhje me hetimet konfidenciale të TFHS-së/ZPS-së. **Hysni GUCATI, Nasim HARADINAJ** dhe ndihmësit pranuan që me ligj, identiteti dhe të dhënat personale të dëshmitarëve nuk duhej të shpërndahen publikisht. Përkundrazi, në përputhje me Ligjin, informacioni konfidencial duhej të ishte zbuluar vetëm në kontekstin e procedimeve penale, në varësi të garancive dhe masave mbrojtëse të nevojshme.

35. Sikurse përshkruhet në paragrafët 22 dhe 32 më lart, zbulimi i paautorizuar i identitetit dhe të dhënave personale të dëshmitarëve të mbrojtur rezultoi në pasoja të rrezikshme për dëshmitarët dhe pengoi rëndë hetimet e ZPS-së.

Format e përgjegjesisë penale

36. Bazuar në faktet e paraqitura në paragrafët 4-22, **Hysni GUCATI** dhe **Nasim HARADINAJ** mbajnë përgjegjësi penale individuale për veprat penale të përshkruara më lart përmes formave të përgjegjesisë penale të renditura në vijim. Sikurse përshkruhet në paragrafët 45-46, ata kishin dijeninë dhe synimin e nevojshëm për secilën formë të përgjegjesisë penale dhe secilën vepër penale.

Kryerja dhe tentimi

37. **Hysni GUCATI** dhe **Nasim HARADINAJ** i kryen veprat penale përmes veprimeve dhe mosveprimeve të përshkruara në paragrafët 6-9, 11, 13-14, 16-18, 20.

38. Gjithashtu ose në alternativë, nëpërmjet veprimeve dhe mosveprimeve të përshkruara në paragrafët 6-9, 11, 13-14, 16-18, 20, **Hysni GUCATI** dhe **Nasim HARADINAJ** tentuan, në kuptim të nenit 28 të KPK-së, të kryenin veprat penale të

pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, frikësimit gjatë procedurës penale, hakmarrjes dhe shkeljes së fshehtësisë së procedurës, përmes zbulimit të identitetit dhe të dhënave personale të dëshmitarëve të mbrojtur.

Bashkëkryerja dhe marrëveshja për të kryer veprë penale

39. Sikurse del qartë nga qëllimi i deklaruar i tyre i pengimit të DHS-së/ZPS-së, si dhe nga veprimet e bashkërenduara për realizimin e qëllimit të përbashkët të përshkruara në paragrafët 6-9, 11-14, 16-18, dhe 20-21, **Hysni GUCATI, Nasim HARADINAJ** dhe ndihmësit i kryen veprat penale bashkërisht dhe/ose ranë në marrëveshje për kryerjen e veprave penale.

40. **Hysni GUCATI** dhe **Nasim HARADINAJ** kontribuan konsiderueshëm dhe ndërmoren veprime të rëndësishme për kryerjen e veprave penale, në realizimin e qëllimit ose marrëveshjes së përbashkët, ndër të tjera nëpërmjet njëres apo më shumë prej mënyrave të mëposhtme, sikurse përshkruhet më hollësisht në paragrafët 6-9, 11, 13-14, 16-18, 20:

- i. këqyrjes së informacionit konfidencial;
- ii. vendimmarrjes ose pjesëmarrjes në vendime nëse dhe si të shpërndahej informacioni konfidencial;
- iii. organizimit dhe pjesëmarrjes në ngjarje, duke përfshirë konferenca për shtyp dhe paraqitje publike, në të cilat informacioni konfidencial u shpërnda dhe u diskutua publikisht;
- iv. shpërndarjes së informacionit konfidencial;
- v. zbulimit të identitetit dhe të dhënave personale të dëshmitarëve, ndër të cilët dëshmitarë të mbrojtur;
- vi. akuzave kundër dëshmitarëve dhe komenteve nënçmuese në lidhje me dëshmitarët;
- vii. inkurajimit dhe këshillimit të personave me qasje në informacion konfidencial në lidhje me procedurat e DHS-së që të vazhdonin t'i jepnin

informacion të tillë OVL-UÇK-së, si dhe premtimeve se do të vazhdonin të shpërndanin informacion të tillë konfidencial; dhe/ose

- viii. inkurajimit, udhëzimit dhe këshillimit të përfaqësuesve të mediave dhe publikut që të merrnin ose incizonin informacionin konfidencial dhe ta shpërndanin më tej.

Nxitja

41. Nëpërmjet një apo më shumë veprimeve të përshkruara në paragrafin 40(ii)-(viii), **Hysni GUCATI** dhe **Nasim HARADINAJ** nxitën njëri-tjetrin, ndihmësit dhe të tjerë, konkretisht (i) personat të cilët, përmes mjeteve elektronike ose me praninë e tyre fizike, morën pjesë, përcollën, ose ndryshe u informuan, për tri konferencat për shtyp dhe deklaratat e tjera publike të përshkruara në paragrafët 8-9, 11, 13-14, 16-18 dhe 20 më lart; (ii) disa përfaqësues të shtypit; dhe (iii) persona që posedonin ose kishin qasje në informacion konfidencial jopublik në lidhje me procedurat e DHS-së (bashkërisht "persona të tjerë") që të kryenin veprat penale të lartpërmendura.

42. Gjithashtu ose në alternativë, nëpërmjet një apo më shumë veprimeve të përshkruara në paragrafin 40(ii)-(viii), **Hysni GUCATI** dhe **Nasim HARADINAJ**: (i) nxitën njëri-tjetrin, ndihmësit, dhe persona të tjerë, që të kryenin veprat penale të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, frikësimit gjatë procedurës penale, hakmarrjes dhe shkeljes së fshehtësisë së procedurës; dhe (ii) u tentua kryerja e këtyre veprave penale.

43. Gjithashtu ose në alternativë, nëpërmjet një apo më shumë veprimeve të përshkruara në paragrafin 40(ii)-(viii), **Hysni GUCATI** dhe **Nasim HARADINAJ**: (i) nxitën njëri-tjetrin, ndihmësit, dhe persona të tjerë, që të kryenin veprat penale të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, frikësimit gjatë procedurës penale dhe shkeljes së fshehtësisë së procedurës përmes zbulimit të identitetit dhe të dhënave personale të dëshmitarëve të mbrojtur; dhe (ii) vepra të tilla penale nuk u kryen, e as u tentua të kryheshin.

Ndihma

44. Së fundi, nëpërmjet një apo më shumë veprimeve të përshkruara në paragrafin 40, **Hysni GUCATI** dhe **Nasim HARADINAJ** ndihmuan njëri-tjetrin, ndihmësit, dhe persona të tjerë, në kryerjen e veprave penale të përshkruara më lart.

Synimi

45. Sikurse del qartë nga sjellja dhe deklaratat e qëllimshme të tyre të përshkruara në paragrafët 5-9, 11-14, 16-18, dhe 20-21, ndër të cilat shpërndarja e informacionit konfidencial, akuzat kundër dëshmitarëve, indiferenca ndaj sigurisë së dëshmitarëve, deklaratat në të cilat pranojnë natyrën konfidenciale të informacionit konfidencial, si dhe qëllimi i deklaruar i pengimit të punës së DHS-së/ZPS-së, **Hysni GUCATI**, **Nasim HARADINAJ**, dhe, sipas rastit, ndihmësit dhe persona të tjerë, synuan kryerjen e veprave penale të përshkruara më lart dhe nxitjen e tyre dhe ndihmën në kryerjen e tyre.

46. Në alternativë, sikurse del qartë nga sjellja dhe deklaratat e qëllimshme të tyre, **Hysni GUCATI**, **Nasim HARADINAJ**, dhe, sipas rastit, ndihmësit dhe persona të tjerë: (i) ishin të vetëdijshëm se si pasojë e veprimeve ose mosveprimeve të tyre, mund të kryheshin veprat penale të përshkruara më lart, dhe se veprimet apo mosveprimet e tyre mund të nxisnin kryerjen e veprave penale apo të ndihmonin në kryerjen e tyre; dhe (ii) u pajtuan me kryerjen e tyre.

PARAQITJA E VEPRAVE PENALE

47. Nëpërmjet veprimeve dhe mosveprimeve të përshkruara më lart, **Hysni GUCATI** dhe **Nasim HARADINAJ**:

- i. kryen, vetëm ose bashkë me të tjerë, veprat penale të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, frikësimit gjatë procedurës penale, hakmarrjes dhe shkeljes së fshehtësisë së procedurës;
- ii. tentuan të kryenin veprat penale të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, frikësimit gjatë procedurës penale,

- hakmarrjes dhe shkeljes së fshehtësisë së procedurës përmes zbulimit të identitetit dhe të dhënave personale të dëshmitarëve të mbrojtur;
- iii. u morën vesh që të kryenin veprat penale të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, frikësimit gjatë procedurës penale, hakmarrjes dhe shkeljes së fshehtësisë së procedurës, dhe ndërmorën veprime të rëndësishme për kryerjen e këtyre veprave penale;
- iv. nxitën dhe ndihmuan kryerjen e veprave penale të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, frikësimit gjatë procedurës penale, hakmarrjes dhe shkeljes së fshehtësisë së procedurës;
- v. nxitën kryerjen e veprave penale të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, frikësimit gjatë procedurës penale, hakmarrjes dhe shkeljes së fshehtësisë së procedurës, dhe u tentua kryerja e këtyre veprave penale; dhe/ose
- vi. nxitën kryerjen e veprave penale të pengimit të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare, frikësimit gjatë procedurës penale dhe shkeljes së fshehtësisë së procedurës përmes zbulimit të identitetit dhe të dhënave personale të dëshmitarëve të mbrojtur, dhe vepra të tilla penale nuk u kryen, e as u tentua të kryheshin.

48. **Hysni GUCATI** dhe **Nasim HARADINAJ** mbajnë përgjegjësi penale individuale për:

Pika 1: PENGIM TË PERSONAVE ZYRTARË NË KRYERJEN E DETYRAVE ZYRTARE, me anë të kërcënimit të rëndë, midis më së paku 7 dhe 25 shtatorit 2020, VEPËR PENALE KUNDËR RENDIT PUBLIK, e ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 28, 31, 32(1)-(3), 33, 35, dhe 401(1) e (5) të KPK-së, dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit;

Pika 2: PENGIM TË PERSONAVE ZYRTARË NË KRYERJEN E DETYRAVE ZYRTARE, me anë të pjesëmarrjes në veprimin e përbashkët të një grupi, midis më së paku 7 dhe 25 shtatorit 2020, VEPËR PENALE KUNDËR RENDIT PUBLIK, e

ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 28, 32(1)-(3), 33, 35, dhe 401(2)-(3) e (5) të KPK-së, dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit;

Pika 3: FRIKËSIM GJATË PROCEDURËS PENALE, midis më së paku 7 dhe 25 shtatorit 2020, VEPËR PENALE KUNDËR ADMINISTRIMIT TË DREJTËSISË DHE ADMINISTRATËS PUBLIKE, e ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 28, 31, 32(1)-(3), 33, 35, dhe 387 të KPK-së, dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit;

Pika 4: HAKMARRJE, midis më së paku 7 dhe 25 shtatorit 2020, VEPËR PENALE KUNDËR ADMINISTRIMIT TË DREJTËSISË DHE ADMINISTRATËS PUBLIKE, e ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 28, 31, 32(1)-(2), 33, 35, dhe 388(1) të KPK-së, dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit;

Pika 5: SHKELJE TË FSHEHTËSISË SË PROCEDURËS, përmes zbulimit të paautorizuar të informacionit të fshehtë të nxjerrë në procedura zyrtare, midis më së paku 7 dhe 25 shtatorit 2020, VEPËR PENALE KUNDËR ADMINISTRIMIT TË DREJTËSISË DHE ADMINISTRATËS PUBLIKE, e ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 31, 32(1)-(2), 33, 35, dhe 392(1) të KPK-së, dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit; dhe

Pika 6: SHKELJE TË FSHEHTËSISË SË PROCEDURËS, përmes zbulimit të paautorizuar të identitetit dhe të dhënave personale të dëshmitarëve të mbrojtur, midis më së paku 7 dhe 25 shtatorit 2020, VEPËR PENALE KUNDËR ADMINISTRIMIT TË DREJTËSISË DHE ADMINISTRATËS PUBLIKE, e ndëshkueshme në bazë të neneve 17, 28, 31, 32(1)-(3), 33, 35, dhe 392(2)-(3) të KPK-së, dhe neneve 15(2) dhe 16(3) të Ligjit.

49. Të gjitha pjesët e kësaj Aktakuze duhen lexuar në lidhje me njëra-tjetrën.

/nënshkrim/

Xhek Smith

Prokurori i Specializuar

E hënë, 4 tetor 2021

Në Hagë, Holandë.